



KE: 0390/ 320 010
E-mail: nplsagj@gmail.com
Info: 0390/ 324 268
Web:

N.P.L. "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A.
GJAKOVË

Komuna e Gjakovës
Opština Djakovica Gjakova Municipality
N.P.L. "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A.

GJAKOVË

Nr. 217

Data: 06.05.2023

NUI: 811444900

Nr. TVSH: 330311853

BEK: 1402000001784638

FTESË PËR ANKAND PUBLIK
QIRADHËNIE TË LOKALIT AFARIST NË N.P.L."STACIONI I
AUTOBUSËVE"SH.A.,GJAKOVË.

1. Dhënia e lokalit afartist me qira

N.P.L. "Stacioni i Autobusëve"SH.A.,Gjakovë njofton të gjithë të interesuarit se ofron lokal afartist për qiradhënie përmes Ankandit Publik si në vijim:

NR.	NJËSIA	Sipërfaqe m ²	Çmimi Fillestar €
1.	Lokal Afartist (lokali gjendet me pozicion përballë peronëve)	7 m ²	90.00 €

Shënim: Çmimi i paraqitur llogaritet pa TVSH.

Kriter i dhënies së kontratës është: çmimi më i lartë i ofruar.

Preferencat e dëshirueshme për lëshimin e lokalit me qira:

1. Për lokalin Nr.1 preferohet agjension turistik, zyrë postare, zyrë përfaqësuese, dyqan afartist dhe të ngjashme.

Të drejtë pjesmarrje kanë si **personat fizik** (të cilët duhet të sjellin një kopje të letërnjoftimit dhe vërtetimin nga gjykata se nuk janë nën hetime) ashtu dhe **personat juridik** (të cilët duhet të paraqesin certifikatën e regjistrimit të biznesit)

Të interesuarit janë të obliguar t'i paraqesin ofertat e tyre përmes plotësimit të formularit me shkrim (formulari terheqet në zyrën e Shërbimit Juridik), duke bashkangjitur edhe dokumentacionin përcjellës të lartcekur, në pliko të mbyllur, në zyrën e Shërbimit Juridik të Ndërmarrjes, çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00.

Ankandi mbetet i hapur nga datë 04.05.2023 deri më 19.05.2023 , në ora 12:00.

Hapja e ofertave do të bëhet më datë 19.05.2023 në ora 13:00 në sallën e madhe në katin I të N.P.L."Stacioni i Autobusëve"SH.A.,Gjakovë, nën praninë e komisionit.



Të drejtë pjesëmarrje në hapjen e ofertave kanë të gjithë ofertuesit.

2.Kushtet dhe obligimet tjera

- Nga e drejta për pjesëmarrje në ankand janë të përjashtuar të gjithë debitorët që kanë obligime të pa shlyera ndaj N.P.L.”Stacioni i Autobusëve”SH.A.,Gjakovë.
- Të gjitha palët e interesuara mund t’a shikojnë lokalit afarist çdo ditë pune nga ora 08:00 deri 16:00.
- Orë matësi i rrymës dhe ujit duhet të jetë i ndarë dhe i regjistruar në emër të personit fizik/juridik fitues.
- Për çdo investim brenda dhe jashtë lokalit duhet paraprakisht të merret leja me shkrim nga qiradhënësi.
- Pala fituese në afatin prej 5 ditësh pas mbylljes së procedurës së ankandit duhet të nënshkruajnë kontratën mbi qiranë, dhe të bëjnë pagesën e faturës së parë.
- Informatat më të hollësishme mund të merren përmes e-mail-it: nplsagi@gmail.com.

Gjakovë, 04.05.2023

